

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË E SPORTEVE

STATUTI I ARKIVIT QËNDROR SHTETËROR TË FILMIT

MIRATOHET: MINISTRI YLLI PANGO

Tiranë 2007

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Veprimtaria e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit (më tej AQSHF) mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për kinematografinë", Ligjin Nr. 9353, datë 03.03.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për kinematografinë", Ligjin nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat", Ligjin 9386, dt. 04.05.2005 "Për muzetë", Ligjin nr. 9380 dt. 28.04.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të" si dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi për dokumentet në figurë të lëvizëshme dhe në zë (filma, fono, fotografi). AQSHF ka selinë në Tiranë dhe ka vulën dhe logon e vet. Vula e institucionit prodhohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 474, dt. 10.07.2003. Logoja e institucionit miratohet nga titullari i institucionit.

Neni 2

AQSHF me veprimtarinë e tij zbaton politikën dhe strategjinë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për mbledhjen, ruajtjen, mirëmbajtjen, përpunimin shkencor arkivor të filmit dhe të çdo materiali tjetër shoqëruar që lidhet me të, për kërkime në fushën e kinematografisë, botime, administrim dhe shfrytëzim të këtyre materialeve arkivore filmike si dokumente artistike, historike dhe me vlera të veçanta.

AQSHF, pjesë e rrjetit arkivor kombëtar, ka varësi metodologjike-profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Veprimtaria e saj mbështetet gjithashtu në normat tekniko-profesionale dhe metodologjike që hartohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

KAPITULLI II

PARIMET DHE FUNKSIONET

Neni 3

AQSHF, sipas nenit 28, të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar, është institucion buxhetor, person juridik publik me statusin e objektit të rëndësisë së veçantë në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe pjesë e rrjetit arkivor tipologjik kombëtar, në bazë të Ligjit nr. 9154, dt. 6.11.2003 "Për arkivat", dhe Ligjit 9386, dt.

04.05.2005 "Për muzetë".

AQSHF, në kuptim të nenit 3, pika 1/c të Ligjit 9386, dt. 04.05.2005 "Për muzetë", në kuptim të nenit 3, pika 12, të ligjit nr. 9048, dt. 7. 04. 2003 "Për trashëgiminë kulturore", është institucion shtetëror i specializuar.

AQSHF është anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Arkivave të Filmit (FIAF) me të drejta të barabarta.

Neni 4

Mbështetur në Ligjin nr. 9048, datë 07. 04. 2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, ligjin nr. 9154, dt. 6.11.2003 "Për arkivat" dhe në Ligjin 9386, dt. 04.05.2005 "Për muzetë", AQSHF ka për detyrë:

- a). Depozitimin, ruajtjen, mirëmbajtjen, restaurimin e të gjithë fondit filmik shqiptar ose të huaj që disponon.
- b). Grumbullimin e të gjithë materialeve shoqëruese të filmit si, skenarë letrarë dhe tekniko – regjisorialë, listë – montazhe, listë – dialogje, fotografi nga filmi, skica dekoresh, postera, ilustrime, materiale të distribuimit të filmit si dhe materiale të tjera që shoqërojnë filmin.
- c). Krijimin e një aparati informativ shkencor nëpërmjet kartelave bazë shkencore, skedarëve dhe informatizimin e tyre në funksion të studimeve të ndryshme .
- d). Vënien në shërbim të kineastëve, studiuesve, studentëve të artit si dhe të publikut të gjerë të fondit dhe materialit shoqërues të tij me qëllim përhapjen e kulturës kinematografike në përputhje me detyrimet e nenit 29 të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar.
- e). Krijimin e katalogeve tematikë.
- f). Të lidhë marrëveshje depozitimi dhe shfrytëzimi promociional që në dorëzim të materialit filmik në fondin e AQSHF në përputhje me detyrimet e nenit 29 të Ligjit « Për kinematografinë », i ndryshuar.
- g). Të respektojë të drejtën e autorit për të gjitha veprat që ka në posedim, bazuar në Ligjin nr. 9380 dt. 28.04.2005 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të".
- h). Si pjesë e sistemit arkivor tipologjik, bashkëpunon me DPA dhe zbaton rregulloret dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të Ligjit nr. 9154, dt. 6.11.2003 "Për arkivat".

Neni 5

AQSHF pasuron fondin e vet :

- a) Nëpërmjet depozitimit legal në fondin e saj, të çdo krijimtarië filmike shqiptare të të gjitha gjinive dhe formateve të çdo veprë të xhiruar në gjuhën shqipe ose bashkëprodhim me të huajt që janë subvencionuar pjesërisht apo tërësisht nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.
- b) Nëpërmjet depozitimit vullnetar të të gjitha llojeve dhe formateve të veprave audiovizuale të prodhuar nga producentë shqiptarë ose të huaj, pasi të kenë marrë miratimin e Këshillit Shkencor të AQSHF.
- c) Nëpërmjet xhirimeve arkivale të AQSHF sipas një plani të miratuar nga Këshilli Shkencor i AQSHF dhe nëpërmjet sigurimit të materialeve filmike nga të tretët.
- d) Nëpërmjet shkëmbimeve të materialeve arkivore në kushte reciprociteti për zgjerim dhe pasurim të fondit, me homologë shtetërorë dhe privatë, vendas dhe të huaj, si dhe blerje të

materialeve të rralla, me vlera të veçanta unikale mbi Shqipërinë në përputhje me detyrimet e nenit 30 të Ligjit « Për kinematografinë », i ndryshuar.

e) Njëpërmjet rifreskimit, rikopjimit dhe restaurimit të fondit qarkullues.

f) Njëpërmjet grumbullimit të çdo materiali që ka të bëjë me historinë e kinematografisë shqiptare dhe studimeve për të.

Neni 6

AQSHF bashkëpunon dhe krijon lidhje me institucione homologe ose organizma të tjera në vende të ndryshme të botës për propagandimin e kinematografisë shqiptare, për problemet e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së materialit filmik, veprimtari të përbashkëta, shkëmbime filmash e materialeve që kanë lidhje me ta.

Shkëmbimi i materialeve arkivore për zgjerimin e pasurimit të inventarit të tij me homologë shtetërorë e privatë brenda e jashtë vendit, në kushte të reciprocitetit bëhet vetëm me miratim të Ministrisë së TKRS mbështetur nenit 19, 20 të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar dhe nenit 30 të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar.

Neni 7

AQSHF, organizon aktivitete promovuese për kineastë dhe vepra kinematografike
AQSHF boton libra, katalogë, guida të ndryshme dhe fletëpalosje mbi kinematografinë, duke i vënë në dispozicion të kineastëve, studiuesve shkencorë, studentëve, brënda e jashtë vendit.
AQSHF ndërton, mirëmban dhe freskon vazhdimisht sitin e internetit me fonde buxhetore ose me fonde të grumbulluara nga sponsorizimet dhe veprimtari të tjera të ligjshme.

Neni 8

Duke u mbështetur në nenin 29 të Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar, dhe në këtë statut, për shfrytëzimin e fondeve arkivore AQSHF ka të drejtë :

a). Të verë në shërbim të kineastëve, prodhuesve të filmit, studiuesve, massmedias, institucioneve shkencore, studentëve, shkollave të artit, historianëve, shoqatave respektive, universiteteve, grupeve të ndryshme të xhirimeve etj., fondin filmik dhe materialin shoqëruar të tij, kundrejt tarifave të shërbimit të miratuara nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

b). Të riprodhojë në formate të ndryshme materiale filmike arkivore sipas kërkesave të të treteve për rastet e parashikuara nga rregullorja e brendshme e AQSHF pasi të jete bere miratimi nga Komisioni i Vizionimit i ngritur nga QKK.

c). Të organizojë vizionime të llojeve të ndryshme brenda ambjenteve të veta për grupe, individë si dhe shfaqje tematike dhe të profilizuara.

Neni 9

AQSHF krijon lidhje dhe organizon veprimtari të përbashkëta me institucionet homologe që vepronë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen, qarkullimin dhe studimin e trashëgimisë filmike mbarëkombëtare shqiptare.

Neni 10

AQSHF gëzon të gjitha të drejtat dhe zbaton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia në FIAF dhe në institucionet e tjera ndërkombëtare të arkivave të filmit.

Neni 11

Për realizimin e funksioneve të saj, AQSHF bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurisë Kulturore, si dhe me të gjitha institucionet e tjera kombëtare vendore që lidhen me trashëgiminë kulturore të të gjitha fushave. AQSHF jep ndihmë profesionale për arkivat që administrojnë dokumente në figurë e në zë.

KAPITULLI III

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Organet drejtuese

Neni 12

Struktura dhe organika e AQSHF propozohen nga Ministri i TKRS dhe miratohet nga Kryeministri në përputhje me Ligjin Nr. 9000, dt. 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".

Gjithë veprimtaria e AQSHF realizohet mbi bazën e palnit vjetor që miratohet nga Ministri i TKRS.

Neni 13

Marrëdhëniet juridike të punonjësve të AQSHF rregullohen në bazë të ligjit nr. 7961, dt. 12.07.1995 "Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse. Punonjësit organikë të AQSHF janë organizuar në sektorë të cilët drejtohen nga përgjegjësit e tyre.

Të drejtat dhe detyrat e stafit drejtues dhe punonjësve që varen prej tyre përcaktohen në rregulloren e brendëshme të AQSHF e cila miratohet nga drejtuesi i institucionit.

Neni 14

Drejtori i AQSHF emërohet, lirohet apo shkarkohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 173, dt. 07.03.2003 "Për emërimin, lirin dhe shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave dhe Ministrive".

Ai drejton dhe kordinon punën e të gjithë sektorëve në përbërje të AQSHF, si dhe përfaqëson

institucionin në marrëdhënie me të tretët.

Drejtori i AQSHF është njëkohësisht edhe Kryetar i Këshillit Shkencor të AQSHF.

Neni 15

Drejtori i AQSHF në cilesinë e punëdhënësit, merr dhe largon nga puna mbi bazë kontrate të gjithë punonjësit e tij në bazë të Ligjit nr. 7961, dt. 12.07.1995 "Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe rregullores së brendshme të AQSHF.

Neni 16

Nëndrejtori i AQSHF drejton punën administrative, manaxhuese si edhe veprimtarinë ekonomike të institucionit. Ai emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me propozim të Drejtorit të AQSHF dhe Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore, mbështetur në kriteret e përcaktuara për këtë pozicion.

Neni 17

Pranë AQSHF funksionon Këshilli Artistik-Shkencor i cili është organ jofunksional, vendimmarrës. Këshilli përbëhet prej 8 anëtarësh. Në të marrin pjesë :

1. Drejtori i AQSHF	Kryetar
2. N/Drejtori i AQSHF	anëtar
3. Përfaqësues i MTKRS	anëtar
4. Përfaqësues i MTKRS	anëtar
5. Personalitet i fushës së kinematografisë	anëtar
6. Drejtori i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë	anëtar
7. Jurist	anëtar

Këshilli Shkencor i AQSHF i zhvillon mbledhjet e tij kur janë prezent jo më pak se 5 nga anëtarët e tij. Këshilli Shkencor i AQSHF i merr vendimet e tij me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

E tërë veprimtaria e Këshillit Shkencor bazohet në VKM nr. 121, dt. 25.02.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 540, dt. 21.12.1992, të Këshillit të Ministrave. "Për krijimin e Këshillave të Kulturës dhe shpërblimin e tyre" të ndryshuar dhe në Udhëzimin nr 1, dt. 24.05.2005 të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturorë".

Këshilli Shkencor propozohet nga Drejtoria e AQSHF dhe miratohet nga Ministri i TKRS. Këshilli Shkencor mund të zëvendësojë një nga anëtarët e tij me kërkesën e këtij të fundit ose me propozim të Drejtorit të AQSHF i cili pas motivimit me shkrim të zëvendësimit, e paraqet për miratim atë (propozimin) tek Ministri i TKRS. Ndryshimi i përbërjes së Këshillit Shkencor bëhet sipas së njëjtës procedure.

Neni 18

Këshilli Artistik-Shkencor mbikqyr gjendjen e fondit arkivor, mundësite e ripërteritjes së tij, planin vjetor dhe projektet e zbatimit të politikës shtetërore të trashëgimisë filmike, kontribuon në të gjitha raportet vjetore të AQSHF për MTKRS ose institucionet ndërkombëtare anëtare e së cilës është AQSHF.

KAPITULLI IV

ORGANIZIMI FINANCIAR

Neni 19

AQSHF është institucion buxhetor. AQSHF përdor të ardhurat e krijuara nga aktivitetet si dhe nga çdo e ardhur tjetër e ligjshme, që sigurohet nga fondacione, organizata dhe institucione, vendase ose të huaja, shtetërore ose private apo nga personat fizike ose juridike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 20

AQSHF paraqet për miratim në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, çdo 30 Qershor, planin vjetor të vitit të ardhshëm dhe investimet, shoqëruar nga preventivat përkatës.

KAPITULLI V

NDRYSHIMET NE STATUT

Neni 21

Statuti i AQSHF miratohet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Statut bëhen me propozim të Këshillit Shkencor të AQSHF dhe Drejtorisë së AQSHF dhe strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Tiranë, më 18/07/2007